



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
Ministri

Nr. 7979 Prot.

Tiranë, më 27.10.2014

URDHËR

Nr. 421, datë 27.10.2014.

PËR

**PËRDORIMIN E FONDEVE TË PLANIFIKUARA PËR BLERJEN E LIBRAVE PËR
BIBLIOTEKAT E SHKOLLAVE TË ARSIMIT PRAUNIVERSITAR.**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, Ligjit Nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Financave në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, të detajojë buxhetin në zërin "Shpenzime për krijim biblioteke" për çdo DAR/ZA sipas formulës "Nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor".
2. Të përdoret ky fond biblioteke për blerjen e librave të literaturës artistike, filozofike, sociale, historike, shkencore dhe didaktike.
3. DAR/ZA të detajojë fondin përkatës si më poshtë:
 - a) Të mbajë 1% të fondit për bibliotekën e DAR/ZA-së.
 - b) Të detajojë për secilën shkollë pjesën tjetër të fondit sipas formulës "Nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor".
4. DAR/ZA-të do të sigurojnë libra për bibliotekat e shkollave vetëm sipas listave bashkëlidhur këtij urdhëri;
5. Mbi bazën e porosive të secilës shkollë për libra të bibliotekës, DAR/ZA-ja i siguron ata libra sipas procedurave të prokurimit në zbatim të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, ndjek realizimin e kontratave dhe kryen financimin përkatës.
6. Procedurat më të hollësishme për përdorimin e fondit për librat e bibliotekave përshkruhen në rregulloren "Për përdorimin e fondeve të planifikuara për blerjen e librave për bibliotekat e shkollave të sistemit arsimor parauniversitar".

6. Procedurat më të hollësishme për përdorimin e fondit për librat e bibliotekave përshkruhen në rregulloren "Për përdorimin e fondeve të planifikuara për blerjen e librave për bibliotekat e shkollave të sistemit arsimor parauniversitar".
7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Financave, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA



MINISTËR

